

Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim

SHENJAT E HIZBINJËVE

Parathënie

Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë vetëm Allahut, kurse salavatet dhe selamet më të mira qofshin për të Dërguarin e Allahut, Muhammedin alejhis-salatu ves-selam, familjen e tij, shokët e tij si dhe gjithë ata që pasojnë rrugën e tij, deri në Ditën e Gjykimit. Dhe në vazhdim them:

Kur fillova të mendoja për hartimin e kësaj teme, më qe sugjeruar se duhet t'i jepja zemër vetës me një thënie të Muhaddithit të famshëm, hoxhës sonë dhe hoxhës së mbarë selefive, shejh Albanit - Allahu e mëshiroftë -, i cili, kur kishte dëgjuar se bidatçinjtë thonë për Selefite se janë përçarës, kishte thënë:

"Është e vërtetë se ne jemi përçarës, sepse ne përçajmë *hakun*/të vërtetën nga *batili/e kota*".

Nisur nga shumë ajete Kur'anore ku Allahu Fuqiplotë na urdhëron për veçimin e hakut nga *batili*, si p.sh thënia e Tij: "**Sikur Haku (e vërteta) të përputhej me tekat e tyre, do të ishin shkatërruar qiejt, toka dhe çka ka mes tyre...**" (El-Mu'minun:71), dhe shumë haditheve inkurajuese lidhur me këtë si dhe konsensusin e mbarë dijetarëve të Selefite për lejimin e sqarimit të devijimeve të të devijuarve dhe kërkesës së një grupi selefij shqiptarë në përpilimin e një teme që pasqyron shenjat më dalluese të Hizbinjve në përgjithësi, morra guximin dhe vullnetin ta shkruaj këtë temë, duke shpresuar se sado pak do t'ia ndriçoj jetën vëllezërve tanë selefij, që të jenë sa më të fortë në përhapjen e rrugës së vërtetë të Selefite.

Fillimisht, çdo musliman duhet të dijë se Selefizmi si rrugë e fesë është e përkryer, mbi të gjitha e mbrojtur nga ana e Allahut *xhe-le she'nuhu*, deri në Ditën e Gjykimit. Për këtë arsye, kolosët e mëdhenj të Ehli Sunnetit dhe Xhematit kanë thënë: "*el-Intisabu iles-selef intisabun ilel-ismet*", që në gjuhën shqipe ka kuptimin: "Përkatësia ndaj Selefizmit është përkatësi ndaj pagabueshmërisë"¹.

Pra, feja e Allahut në pajtueshmëri me Sunnetin e Muhammedit, alejhis-salatu ves-selam, dhe rruga e Sahabëve është nën mbrojtjen e Allahut, deshëm apo nuk deshëm. Mirëpo, derisa Allahu çdo gjenerate ia ka ofruar këtë rrugë dhe

¹ *Es-selefijjetu, hakikatuha ve usuluha* e Shejh Albanit(21). Përmbledhi Amër AbdulMun'im

ia ka mundësuar mbrojtjen e saj, atëherë pse edhe ne të mos jemi një hallkë vazhduese e mbrojtjes së kësaj rruge të shenjtë?

Muhammedi, alejhi-selam, thotë:

"Do ta mbajnë mbi supe (origjinalitetin) e diturisë mbi fenë e Allahut të drejtit e çdo gjenerate. Ata do ta mohojnë shtrembërimin e ekstremistëve, devijimin e të devijuarve dhe keqkuptimet e injorantëve".

Lusim Allahun të na bëjë prej robërve të tij që ia kanë frikën Atij, që janë të turpshëm ndaj Tij, të sinqertë dhe mesatarë në çështjet e fesë. Para se të cekim shenjat e Hizbinjëve, është e udhës që së pari të mësojmë gjërat në vijim:

- Argumentet nga Kur'ani, Sunneti dhe Konsensusi i dijetarëve të Selefrit për lejimin e sqarimit të devijimit të të devijuarve.
- Kuptimin e fjalës Hizbij në aspektin etimologjik dhe terminologjik.
- Shenjat e Hizbinjëve bazuar në deklaratimet e dijetarëve të Ehli Sunnetit dhe Xhematit.

Argumente Kur'anore për lejimin e sqarimit të devijimit të të devijuarve

1- Allahu i madhëruar thotë:

"Allahut nuk i përket t'i lë besimtarët ashtu si janë, pa e dalluar të keqin nga i miri". (Ali-Imran: 179)

Ibn Kajjimi - Allahu e mëshiroftë - në librin e tij "Bedaiut-tefsir" (1 \ 536-537) thotë:

"Ky ajet është një nga thesaret më të mëdhenj të Kur'anit, nëpërmjet të cilit Allahu ka sqaruar urtësinë e dallimit të të mirëve nga të këqijtë. Dhe ky dallim i të mirëve nga të këqijtë nuk arrihet, përveçse nëpërmjet metodologjisë së Pejgamberëve të Tij dhe Shpalljes që Ai u dhuroi atyre, me ç'rast ai dalloj nëpërmjet tyre kush është mik i sinqertë i Pejgamberit, kush është armik i tij, kush meriton afrim dhe kujdes dhe kush nuk meriton as nderim e as respektim.

Ajeti fuqimisht argumenton se nuk i përket madhërisë së Allahut të jetë i shkujdesur ndaj sqarimit të të mirëve nga të këqijtë... Ndalo dhe medito mbi këtë ajet me një meditim të thellë. Sikur Allahu të mos kishte zbritur ajet tjetër

pos këtij ajeti, do të kishte mjaftuar për njerëzit që të marrin mësim përgjithmonë. Allahu na udhëzofte në rrugën e udhëzimit".

2- Allahu thotë: "O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri *fasik* (i pandershëm) jua sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (nëse është i vërtetë), që të mos i bëni dëm ndokujt pa dashje e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë". (El-Huxhurat: 6)

Ibn Tejmijeh – Allahu e mëshiroftë - thotë:

"Ajete qartazi argumenton se të argumentuarit me lajmin e njeriut të drejtë nuk është e ndaluar, ndryshe nga *fasiku* nga i cili nuk pranohet lajmi, madje, duhet sqaruar kush është ai".²

Gjithashtu thotë:

"Ajete argumenton se patjetër duhet të vërtetohet lajmi i përhapur nga *fasiku* dhe të sqarohet se nga kush ka rrjedhur lajmi. Allahu ka urdhëruar në verifikimin e lajmit të një *fasiku* e jo shumë *fasikëve*, sepse lajmi i përhapur nga një numër *fasikësh* vetëm se ka shtuar bindjen se lajmi i tyre është besim i tyre, ndryshe nga lajmi i një *fasiku* që nuk aludon në këtë".³

3- Allahu thotë:

"Dhe kështu Ne i shkoqisim hollësisht argumentet, në mënyrë që të qartësohet rruga e njerëzve të këqij". (El-En'am: 55)

Abdurrahman es-Sa'di thotë në Tefsirin e tij (258):

"Është obligim për dijetarët ta veçojnë të vërtetën nga e pavërteta, me qëllim që ta pasojnë ata që dëshirojnë udhëzimin, të pendohen të devijuarit dhe të ngrihet argumenti kundër mendjemëdhenjve... kush sqaron rrugën e udhëzimit nga rruga e devijimit, ai gradohet si trashëgimtar i Pejgamberëve dhe si udhëzues i popujve. Kurse, kush e vesh *hakun* me *batilin* dhe nuk do të dallojë mes tyre, edhe pse e di se cili është *haku* dhe cili *batili*, ai është thirrës për në xhehenem. Kjo, ngase njerëzit nuk gjejnë udhëzimin në jetën e tyre, përveçse nëpërmjet dijetarëve të tyre".

² *Mexhmu'ul-fetava* (3\463).

³ *Mexhmu'ul-fetava* (4\7).

Argumente nga Sunneti i Muhammedit, alejhi salatu ves selam

1- Transmetojnë Buhariu (5707,5780) dhe Muslimi (2591) në koleksionet e tyre nga Aishja - radijAllahu anha -, e cila tregon se një njeri, pasi që i kishte kërkuar Pejgamberit leje për të hyrë, Pejgamberi alejhi-salatu ves-selam kishte thënë për të: 'Sa familjar i keq është ai!' e, pas hyrjes, Pejgamberi, alejhi salatu ves selam, i buzëqeshi dhe i foli me mirësjellje. Kur ai doli, e pyeta Pejgamberin: 'O i dërguari i Allahut, para se të hynte, për të the: 'Sa familjar i keq është ai!' e, kur hyri, i foli me të mirë! Pejgamberi, alejhi salatu ves selam, tha: 'Oj Aishe, a mos vallë më ke parë ndonjëherë të sillem keq me ndokënd. Njerëzit me pozitën më të keqe tek Allahu në Ditën e Gjykimit janë ata, që njerëzit i braktisin nga frika e dëmit të tyre'.

Qëllimi i argumentimit me këtë hadith është se Pejgamberi, alejhi salatu ves selam, e ka cilësuar me të keqe atë njeri, për shkak të interesit fetar, që lidhet me ruajtjen e nderit familjar, me qëllim që të kihet kujdes nga dëmi që mund të lind nga ai.⁴

Konsensusi i dijetarëve Islamikë lidhur me këtë çështje

Të gjithë dijetarët e Ehli Sunnetit dhe Xhematit janë unanim se informimi i devijimit të të devijuarve nga bidatçinjtë dhe pasuesit e ndryshëm të tekave dhe sqarimi i rrezikut të tyre nuk konsiderohet *gibet*/përgojim i ndaluar, por është *vaxhib*/obligim dhe *mustehab*/e rekomandueshme sa herë që paraqitet nevoja.

Imam Maliku thotë:

"Nuk merret dituria nga katër lloje të njerëzve:

- 1) Nga mendjelehti, i cili tregon mendjelehtësi, edhe nëse është transmetuesi më i madh i haditheve;
- 2) Nga tekanjozi që thërret njerëzit në pasimin e tekave të tij;
- 3) Nga gënjeshtari i cili gënjen gjatë të folurit, edhe pse nuk gënjen për Pejgamberin, alejhi salatu ves selam;
- 4) Dhe as nga një shejh që ka devotshmëri dhe të mira përderisa nuk di çka po flet". (*El-Kamil* e Ibn Adijj-it 1\92).

Hakimi thotë:

⁴ "Davabitul-xherhi vet-ta'dil" të Dr.AbdulAziz Abdul-Latif (30).

"Baza e drejtësisë së një Muhaddithi është: të jetë musliman, të mos thërret në bidat dhe as të mos u ekspozohet mëkateve që shkaktojnë cenimin e burrërisë së tij". (*Ma'rifetu ulumil-hadith* të Hakimit: 53)

AbduRrahman ibn Mehdiu thotë:

"Sikur njeriu të mendonte që vetëm të gënjejë në fe, Allahu do ta zbulonte (çështjen e tij)". (*El-Xhami* të Hatib Bagdadit :2\8).

Malik ibn Enesi thotë:

"Dituria është fe. Atëherë, secili le të shikojë se nga kush po e merr fenë". (*Tehdhibul-kemal* të Mizz-it (26\438).

Ebuz-Zinad thotë:

"Kam takuar në Medine njëqind persona dhe të gjithë ishin të pastër dhe të sigurt në fenë e tyre, por dija nuk merrej prej tyre. Dijetarët thoshin për ta: 'Nuk janë prej *ehlu ilmit*/pronarëve të dijes". (*Mukaddimetu sahihu Muslim*: 15)

Umer en-Nakid thotë:

"Feja e Muhammedit, alejhi salatu ves selam, nuk duron dredhi e gënjeshtër". (*El-Kifajeh* të Hatib Bagdadit: 36)

Sido që të jetë, prej atyre dijetarëve që kanë transmetuar këtë konsensus dhe që ata vetë e kanë kryer këtë obligim fetar janë:

1. Shu'betu ibnul-Haxh-xhaxh Thekafiu (vd:160h)
2. Sufjan Thevriu (vd:161h)
3. Malik Ibn Enesi (vd:179h)
4. Abdullah ibnul-Mubareku (vd:181h)
5. Jahja ibn Seid el-Kattani (vd:189h)
6. AbduRrahman ibn Mehdi (vd:189h)
7. Jahja ibn Meini (vd:233h)
8. Alij ibnul-Medini (vd:234h)
9. Ahmed ibn Hanbeli (vd:241h)
10. Muhammed ibn Ismail Buhariu (vd:256h)
11. Muslim ibnul-Haxh-xhaxh Nejsaburi - Imam Muslimi (vd:261h)
12. Ebu Zur'ah err-Rrazi (vd:264h)
13. Ebu Davud Sigjistani (vd:275h)
14. Ebu Hatim err-Rrazi (vd:277h)

15. Muhammed ibn Isa Tirmidhiu (vd:279h)
16. AbduRahman Nesaiu (vd:303h)
17. AbduRahman ibn Ebu Hatimi (vd:327h)
18. Muhammed ibn Hibbani (vd:354)
19. Darekutni (vd:385h)
20. Ebu Abdullah el-Hakim Nejsaburi (vd:405h)
21. Hatib Bagdadi (vd:463h)
22. Neveviu (vd:676h)
23. Dhehebiu (vd:748h)
24. AbduRahim el-Iraki (vd:806h)
25. Ibn Haxher Askalani (vd:852h)
26. AbduRahman es-Sehavi (vd:901h) dhe shumë dijetarë tjerë pas tyre.

Kuptimi i fjalës "Hizb"

Fjala "Hizb" në aspektin etimologjik d.m.th: grup njerëzish apo parti.⁵

Kurse, në terminologjinë Islame, bazuar në thëniet e dijetarëve bashkëkohorë të Ehli Sunnetit dhe Xhematit, dm.th. tubimi dhe bashkimi i një grupi të njerëzve rreth një ideologjie të caktuar, si dhe dashuria dhe urrejtja për hir të atij grupi.

Nisur nga kjo pikëpamje, dijetarët e Ehli Sunnetit çdo grupi të njerëzve besimi dhe metodologjia e të cilëve bie në kundërshtim me atë të Selefiteve thonë Hizbij.⁶

Nëse analizojmë kuptimin e fjalës "Hizb" në Kur'an, vërejmë se Allahu e ka cilësuar me të njëjtin kuptim si "Hizb" çdo grup të jobesimtarëve që kanë qëndruar kundër thirrjes së Muhammedit, alejhi selam.

Allahu thotë:

"Vërtet, kjo feja juaj është një fe e vetme ndërsa Unë jam Zoti juaj, andaj frikësohuni prej Meje! Por, ata (popuj kur u çuan kundër të dërguarit) u ndanë në grupe/Ahzab (shumës i fjalës hizb) në çështje të fesë së tyre. Çdo grup ishte i kënaqur me atë që kishte. Andaj, lëri ata në padijen e tyre për një farë kohe!" (El-Mu'minun: 53-54)

⁵ Mu'xhemu mekajisul-lugah të Ibn Farisit (242).

⁶ Shiko librin "Keshfus-sitar amma tahmiluhu ba'dud-deavat min ahtar" të Shejh Rebi ibn Hadit - Allahu e ruajt -.

Bazuar në këtë ajet Kur'anor, mund të themi se termi "Hizb" është më i gjerë sesa termi "Xhemat". Nuk është për t'u çuditur se sa e gjerë dhe precize është gjuha arabe. Ndaluni dhe meditoni, për Zotin. Nëse analizojmë besimin dhe metodologjinë e të gjitha fraksioneve me të gjitha dallimet dhe ngjyrat davetit që posedojnë, vërejmë se në përfundim të gjithë bashkohen kundër Sunnetit të Muhammedit, alejhi salatu ves selam. Dhe fjala e cila më së miri tregon këtë qëndrim kundërshtie të përgjithshëm të një apo më tepër grupeve ndaj Sunnetit, është fjala "Hizb" apo "Hizbinjë".

Në anën tjetër, fjala "Hizb" përdoret në Kur'an edhe si lavdërim, si p.sh Allahu i ka cilësuar ata që i besojnë Muhammedid, alejhi selam, dhe që luftojnë për triumfin e tij dhe rrugës së Sahabëve si "Hizbullah" apo Palë e Allahut (shiko suren el-Maideh, ajeti:51 dhe suren el-Muxhadeleh, ajeti:22) ashtu siç edhe i ka cilësuar si "Hizbush-shejtan" apo Palë e Shejtanit të gjithë ata që pasojnë devijimet e tij. (shiko suren el-Muxhadeleh, ajeti:19).

Shenjat e Hizbinjëve

Nga cilësitë dhe shenjat kryesore të Hizbinjëve janë këto në vijim:

- 1- Pamja e jashtme e tyre vërehet se është në kundërshtim me Udhëzimin e Muhammedit, alejhis-selam.
- 2- Ngritja dhe lavdërimi i personaliteteve të tyre përtej mase si dhe urrejtja dhe dashja e njerëzve për hir të urrejtjes së personaliteteve të njohura të tyre.
- 3- Argumentimi me ajete frikësuese, qortuese e kërcënuese me xhehennem kundër kundërshtarëve të tyre.
- 4- Argumentimi me ajete dhe hadithe jashtë qëllimeve të tyre (ajeteve dhe haditheve) esenciale.
- 5- Urrejtja e dijetarëve të Ehli Sunnetit dhe talebeve që zbulojnë gabimet dhe dredhitë e tyre.
- 6- Akuzimi i dijetarëve dhe talebeve që kundërshtojnë metodologjinë e tyre me llagape të ulëta dhe poshtëruese, sidomos nëse vërejnë se një grup selefi marrin mendimin e një dijetari kundër tyre ma tepër se sa të të tjerëve.
- 7- Moskërkimi i diturisë nga dijetarët e Ehli Sunnetit që dallohen ma tepër në kundërshtimin e besimit dhe metodologjisë së tyre, krahas pengimit të pjesëtarëve të tyre nga dëgjimi i ligjëratave të tyre.

- 8- Propagandimi se preokupimi me çështjet aktuale në botë dhe përqeshja e prijësve muslimanë është esenca e dijes së shëndoshë dhe e devotshmërisë së fortë.
- 9- Emocionimi i të rinjve më ligjërata për urrejtjen e prijësve muslimanë në emër të Xhihadit, duke shfrytëzuar për këtë sprovat aktuale.
- 10- Reklamimi në prezantimin e ligjeratave të tyre është më me vlerë sesa prezantimi tek dijetarët e Ehli Sunnetit.
- 11- Përdorimi i gënjeshtërisë në interes të davetit të tyre, me pretekstin se "Lufta është mashtrim".
- 12- Përdorimi i sistemit ushtarak me të rinjtë muslimanë, të cilët prezantojnë në kampingjet e tyre, në udhëtimet dhe në piknikët me ta.
- 13- Zgjerimi i përdorimit të shumë ndalimeve e bidateve si mjet daveti, si p.sh ilahijat me instrumente muzikore, dramet, mevludet... etj.
- 14- Joshja dhe afrimi i njerëzve duke ua arsyetuar gabimet, mëkatet e bidatet e tyre, për shkak të interesit material që i lidh ata mes vete.
- 15- Ligjërimi me ngjarje dhe tregime prekëse, të dhimbshme, boshe e të pa baza, dhe të qarët e tyre gjatë ligjërimit për ta bindur dhe afruar masën, kinse këtë e kanë nga devotshmëria.
- 16- Ekspozimi i tyre para masës në emër të Selefizmit dhe mbrojtjes së tij.
- 17- Bashkëpunimi me xhemate që nuk flasin kundër tyre.
- 18- Ambicia për arritjen e posteve të larta në shtet apo në institucionet më të larta fetare të një vendi.
- 19- Organizmi i seminareve dhe tubimeve përkujtimore për lindjen apo vdekjen e ndonjë hoxhe të tyre.
- 20- Mosinteresimi në zbatimin e shumë suneteve, me pretekstin se këto janë si lëvorja e fesë, ndërsa interesohen për thelbin e fesë, që, sipas tyre, është aktualiteti i muslimanëve.
- 21- Të vlerësuarit e suksesit apo mossuksesit të davetit të tyre sipas numrit të madh apo të cekur që prezantojnë në ligjëratat e tyre.

22- Përkrahja e çdo mendimi që nuk cenon interesat e tyre, edhe nëse janë më të devjuarit e një populli.

23- Barazimi apo përngjasimi i hoxhallarëve të tyre me cilësitë, trimëritë e dijetarëve të mëdhenj të Selefit të tre shekujve të parë.

24- Organizimi i darkave, drekave, iftareve vetëm me pasanikët apo me njerëzit me fame, si psh me politikanë, tregtarë, sportist, etj.

25- Prezantimi i tyre në ligjëratat e dijetarëve të Ehli Sunnetit vetëm për të përfituar fame, kinse janë nga nxënësit e afërt të atij dijetari, me qëllim të mbulimit të realitetit të tyre.

26- Akuzimi i dijetarëve dhe talebeve që flasin kundër tyre me pamjaftueshmëri në dije apo edhe si spiunë të shtetit apo të kafirave.

27- Akuzimi i Shejh Albanit si murxhi apo se ka rënë në Irxha.

Literatura e konsultuar:

- *el-Kavlul-emin fi sifatil-hizbijjin* e Abdullah ibn Isa el-Mevri, Jemen, 1417 hixhrij.

- *el-Fetava el-Menhexhijeh dhe es-Selefijjetu hakikatuha ve usuluha* e Shejh Albanit, e përmbledhur nga Amër AbdulMun'im, botuar nga shtëpia botuese "Darud-dijai", Egjipt, botimi i parë, 2008.

- *Menhexhu semahatish-shejh AbdulAziz ibn Baz fir-redi alet-muhalifin*, të cilën e përmbloodhi vëllai i mbretit të Arabisë Saudite Najif ibn AbdulAziz Al Su'ud, nën miratimin e Muhaddithit AbdulMuhsin el-Abbad dhe dijetarit Salih el-Fevzan, botim i dy shtëpive botuese "Darut-te'sil" dhe "Darul-meveddeh", botimi i parë, 2008, Arabi Saudite.

Përgatiti: Abdulmelik - Besfort Maxhuni